



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 487/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.07.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Be-Is” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. ~~REF-~~ 44820-02-07-2018, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës “Çaush Asllani” + rruga “Ismail Xhemali Debrova*”, me fond limit 47.303.370 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Ankimues:

“Victoria Invest” sh.p.k.
Lagja “28 Nëntori”, Rruga “11 Nëntori”, Elbasan

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Elbasan
Rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.02.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF- 44820-02-07-2018, me objekt “*Rikonstruktion i rrugës "Çaush Asllani" + rruga "Ismail Xhemali Debrova"*”, me fond limit 47.303.370 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

II.2. Në datën 26.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit në datë 11.04.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | | |
|--|------------|--------------------|
| 1. BO “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. | 31.444.571 | lekë, skualifikuar |
| 2. BO “Blerimi” sh.p.k. & “Mela” sh.p.k. | 33.600.000 | lekë, skualifikuar |
| 3. “Be-Is” sh.p.k. | 33.661.236 | lekë, kualifikuar |

4. "Victoria Invest" sh.p.k.	34.364.236,34 lekë, kualifikuar
5. "Shendelli" sh.p.k.	35.723.088 lekë, skualifikuar
6. "B-93" sh.p.k.	36.815.468 lekë, skualifikuar
7. "Ergi" sh.p.k.	37.321.111 lekë, kualifikuar
8. "Bajrami N." sh.p.k.	38.693.704,4 lekë, kualifikuar
9. BO "Bahas" sh.p.k. & "Avduli" sh.p.k.	40.693.984 lekë, skualifikuar
10. "Shpresa-Al" sh.p.k.	43.098.298 lekë, kualifikuar
11. "Gjevori" sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
12. "Adem Pojani" sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 17.04.2018 operatori ekonomik "Victoria Invest" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik "Be-Is" sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...] Komisioni i vleresimit të ofertave të autoritetit kontraktor ka kualifikuar operatorin e renditur të parin "BE-IS" sh.p.k. duke anashkuar mangësitë e tij në dokumentacion, duke kryer shkelje të rënde ligjore pasi duket haptazi favorizimi i AK ndaj këtij operatori. I kërkojme Komisionit të Vleresimit të Ofertave të shikoje imtësisht lidhur me arsyet që do të rendisim më poshtë dhe të ndryshojë vendimin e saj lidhur me këte operator ekonomik duke e skualifikuar atë. Shprehim pretendimet tona lidhur me kualifikimin e jashtëligjshëm të operatorit ekonomik "BE-IS" sh.p.k.: 1. Në pikën 2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatoreve ekonomike është kërkuar: a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që verteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitet 2016 dhe 2017. Operatori BE-IS SHPK me date 23.08.2017 ka lidhur kontrate per pune publike me Bashkinë Bulqize me objekt "Qendra e qytetit të ri sheshi para ish Keshillit të Rrethit Bulqize" me vlere 24.213.546 me tvsh. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk e ka deklaruar me QKB si adrese dytesore te ushtrimit te aktivitetit dhe si rrjedhoje nuk ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe nuk ka paraqitur dokument që verteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave vendore. Operatori BE-IS SHPK ka lidhur kontrate per pune publike me date 29.09.2016 me Bashkinë Cerrik me objekt "Ndertimi i Shkolles dhe Palestres. Ndertim i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen 9 vjecare Adem Elmaz Asllani, Shtepanjë, Gostime, Bashkia Cerrik" me vlere 72.948.120 me tvsh me afat 90 dite. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk e ka deklaruar ne QKB si adrese dytesore te ushtrimit te aktivitetit dhe si rrjedhoje nuk ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe nuk ka paraqitur dokument që verteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave vendore. (Shih Njoftim Fituesi bashkelidhur). Ligji nr 9723 date 03.05.2007, i ndryshuar "Per Regjistrimin e Biznesit" [...]. Ky ligj përcakton si detyrim të personit juridik regjistrimin e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë. Me vende të tjera të ushtrimit të veprimtarisë do të kuptojmë ushtrimin e saj në vende të ndryshme nga selia e personit juridik. Subjekti BE-IS SHPK ka ushtruar veprimtari te pavaruar ekonomike, profesionale dhe tregtare per sa kohe eshte person juridik i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, ka objekt te percaktuar, por nga ana tjeter ka detyrimin e regjistrimit te vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise. Gjithashtu veprimtaria ne nje vend te ndryshem nga selia e personit juridik, pavaresisht kohezgjatjes se percaktuar, e cila lidhet me permbushjen e vet objektit te kontrates, nuk e ben kete nje veprimtari jo te vazhdueshme. Duke qene se regjistrimi i

vendeve te aktivitetit eshte detyrim ligjor, autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan ka kerkuar “nje dokument qe verteton se operatori ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2016 dhe 2017”. Si rrjedhoje operatori “BE-IS” sh.p.k. nuk ploteson piken piken 2.1 te DST Per kapacitetin ligjor/profesional i operatoreve ekonomike ku eshte kerkuar: “a) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2016 dhe 2017.”

2. Lidhur me kriterin e mjeteve: 2.3.9 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lloji i Makinerive	Sasia
Kamion vetëshkarkues minimalisht 10 ton	Copë 2
Kamioncina vetëshkarkuese 2-5 ton	Copë 2
Kamion vinç	Copë 1
Eskavatorë me zinxhir $V=0.5 m^3$	Copë 1
Eskavatorë me goma	Cope 1
Minieskavator	Copë 1
Autobote uji	Copë 1
Betoniere 4*4 vetë-ngarkuese (1- 4) m^3	Copë 1
Autobetoniere	Cope 1
Asfaltoshtruese	Copë 1
Fadromë me goma	Copë 2
Minifadrome	Copë 1
Rrul me kompresor	Copë 1
Grejder	Cope 1
Makineri vizimi për bojë biokoponente	Copë 1
Autobitumatrice ose bitumatrice	Cope 1
Krik ngrites me kosh	Copë 2

Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse.

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 9) te shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

- a) Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;
ose
 - b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse

të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes. Për secilin prej mjeteve të paraqiten fotografi të tyre.

-Kamioncinat e paraqitura e kalojnë tonazhin e lejuar.

-Nuk ka paraqitur certifikate për transport mallrash për të gjithë automjetet.

-Automjeti i deklaruar si autobot uji, nuk është autobot uji, por kamion.

-Autoboti (mjet i sjelle nga shoqëria "BE IS" shpk) është i pajisur me certifikate transporti për mallra të rrezikshme: karburant klasa 3, pra ky mjet nuk është autobot uji.

-Nuk është paraqitur asnjë rrul me kompresor.

-Për mjetin Autobotmatrice ka paraqitur fature dhe jo dokumentacionin përkatës si dhe foto ku të evidentohet targa e mjetit.

-Mungon makineria e vijeimit.

-Nuk plotëson kushtin për makinerite: Makinerite nuk i kanë të plotë dokumentat plotësues ose afati u ka skaduar (akt pronesi, siguracion, leje qarkullimi, kolaudim).

3. Nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: "Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim, disa diploma janë paraqitur fotokopje të pashoqëruara me vertetimin e Noterizimit/njehesimit kopjes origjinale me atë fotokopje.

4. Emri i administratorit të shoqërisë nuk gjendet në listpagese pasi nuk figurojnë emri K. Ibrahimit asnjë rresht të saj, por ekziston një emer tjetër K. Ibrahimaj cka do të thote se nuk përputhet emri i administratorit në licencën e ndertimit me asnjë punonjës aktual në listpagesat e shoqërisë.

5. BE-IS shpk ka numer mesatar 77 punonjës për 3 vitet e fundit. Ai nuk plotëson një punësim mesatar i të paktën 80 njerëzve për periudhën Janar 2016 Dhjetor 2017 të vertetuar me listpagesat e këtyre muajve", pasi referuar kontratave të lidhura me autoritetet kontraktore duke u bazuar në buletinet e njoftimeve publike për lidhjen e kontratave me BE-IS sh.p.k, rezultojnë se ky operator ka të angazhuar të gjithë punonjësit e tij në objekte të tjera, ndaj dhe nuk zoteron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/i, cka bie në kundërshtim me pikën 1 të germa (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar [...].

6. Sipas kriterit të mëposhtëm mbi deklarin e punëve në proces: 2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, neni 26, pika 8, germa "ç". Për të provuar plotësimin e kësaj kërkesë duhet të deklarojë të gjitha punët në proces për të cilat ka lidhur kontratë apo është në proces të lidhjes së saj, si kontraktor apo nënkontraktor, sipas ligjit për prokurimin publik, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Objekti i kontratës	Autoriteti Kontraktore	Vlera e kontratës pa tvsh	Data e fillimit të punimeve ose data e parashkuar	Data e përfundimit të punimeve ose data e parashkuar	Dat e përfundimit të punimeve ose data e parashkuar për përfundimin e kontratës	Masa e përfundimit të punimeve fizike në %

				<i>per lidhjen e kontrates</i>		
<u>1</u>						
<u>2</u>						
<u>3</u>						
<u>4</u>						

Nuk janë deklaruar të gjitha kontratat për të cilat është shpallur fitues, gje që vërtetohet në buletinin e njoftimeve të app.

7. Lidhur me kriterin e meposhtem: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm). Ka kontrate pune me mjeken e cila ka perfunduar.

8. Lidhur me kriterin e kapacitetit teknik: 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 7 (shtatë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët:

- Teknik Ndërtimi me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI–sot) 3 (tre)*
- Punonjës Elektriçist me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI–sot) 2 (dy)*
- Punonjës Hidraulik me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI–sot) 2 (dy)*
- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë për punimet në lartësi të lëshuar nga Autoritetet Çertifikuese të Licensuara.*

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Tek inxhinieret e kerkuar ka mosperputhje mes librezes se punes, kontrates se punes dhe CV se, gjithashtu rezultojne kontrata te cilave u ka mbaruar afati.

Sa me siper konsiderojme klasifikimin e BE-IS shpk si vendim te jashteligjshem te Komisionit te Vleresimit te Ofertave te Autoritetit Kontraktor per te gjithe arsyet renditur si me siper. Rrjedhimisht kerkojme pezullimin e procedures, kryerjen e procesit te rivleresimit nga anetaret te tjere te komisionit te vleresimit te meparshem duke s'kualifikuar operatorin "BE-IS" sh.p.k si oferte te pavlefshme dhe shpalljen fitues te shoqerise "Victoria Invest" sh pk. [...].

II.5. Në datën 24.04.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 2443/1 prot., ku është bashkëlidhur vendimi i nr.777/11, datë 24.04.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën me argumentimin si më poshtë vijon:

[...] Ne lidhje me pretendimin tuaj se subjekti BE-IS sh.p.k ka lidhur kontrate per pune publike me date 29.09.2016 me Bashkine Cerrik me objekt "Ndertimi i Shkolles dhe Palestres. Ndertimi i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik" me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk e ka deklaruar ne QKB si adrese dytesore te ushtrimit te aktivitetit dhe si rrjedhoje nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe nuk ka paraqitur

dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore sqarojme se autoriteti kontraktor ne vlesimin nese operatori ekonomik ka shlyer detyrimet qe rrjedhin nga taksat vendore duhet ti referohet vetem vendeve kryesore dhe sekondare te ushtrimit te aktivitetit tregëtar referuar ekstraktit te regjistrit tregëtar. Eshte jashte kompetencave te autoritetit kontraktor ne cilesine e nje organi publik bashki te verifikojë zbatueshmerine e ligjit nga organet e qeverisjes vendore ne rast se keto te fundit kane nisur proceduren e dergimit te kerkeses per regjistrim dhe detyrimin e pagimit te taksave vendore. Ndaj nenvizojme se referuar pretendimit tuaj të mësipërm per skualifikim kjo arsye eshte ne tejkalim të kompetencave dhe i eshte referuar nje kriteri i cili nuk eshte parashikuar ne dokumentat e tenderit duke rene ndesh me nenin 55 pika 2 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar . III.2.5 Ne nenin 46, pika 1, germa "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet [...]. 111.2.6. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet [...] 111.2.7. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. III.2.8. Referuar sa më sipër KSHA vlerëson se në kriterin e vecantë të kualifikimit a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar aktivitetet per vitet 2016 dhe 2017 nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga operatori ekonomik "BE-IS" shpk në përmbushje të këtij kriteri ky i fundit ka dorëzuar vërtetime lëshuar nga Bashkia Vorë, Bashkia Kukës, Bashkia Tiranë, Bashkia Vlorë për vitin 2016 dhe Bashkia Tiranë, Bashkia Vorë, Bashkia Krujë, Bashkia Selenicë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Durrës, Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd, Bashkia Kukës, Bashkia Vlorë për vitin 2017 me anë të të cilave konfirmohet se ofertuesi nuk ka detyrime të papaguara lidhur me takstat dhe tarifave vendore për Vitet 2016-2017 për këto Bashki. Nga verifikimi i ekstraktit të regjistrit tregëtar të ofertuesit të paraqitur në SPE rezulton se ky i fundit ka ushtruar aktivitetin e tij ekonomik vetëm në Bashkinë Vorë, Bashkinë Kukës, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vlorë për vitin 2016 dhe Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vorë, Bashkinë Krujë, Bashkinë Selenicë, Bashkinë Rrogozhinë, Bashkinë Durrës, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Librazhd, Bashkinë Kukës, Bashkinë Vlorë për vitin 2017, për të cilat ka paraqitur vërtetimet përkatëse. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se pretendimi juaj per operatorin ekonomik "BE-IS" shpk se ka lidhur kontrate per pune [publike me date 29.09.2016 me Bashkinë Cerrik me objekt "Ndertimi i Shkolles dhe Palestres, Ndertimi i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik" me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk e ka deklaruar ne QKB si adrese dytesore te ushtrimit te aktivitetit dhe si rrjedhoje nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore, jane te pa pabazuara dhe jo në përputhje me kriteret e kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka detyrimin te vlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në

dokumentat e procedures se prokurimit. Në rastin konkret Komisioni gjykon se ju keni keqinterpretuar kriteret e vendosura nga AK si dhe ligjin për taksat vendore duke kërkuar me pa të drejtë skualifikimin e operatorin ekonomik. Vlerësimi nëse operatorët ekonomikë kanë shlyer detyrimet vendore bëhet në bazë të verifikimit të vendeve të ushtrimit të aktivitetit në periudhën e kërkuar pasi ky është dhe qëllimi dhe fryma e ligjit që detyron subjektet të regjistrojnë vendet ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Në rastin konkret operatori ekonomik “BE-IS” shpk për vitin 2016 -2017 rezulton të ketë shlyer të gjitha detyrimet vendore për vendet e ushtrimit të aktivitetit të regjistruara në QKB duke përmbushur tërësisht kërkesat e kriterit të kualifikimit për dorëzimin e vërtetimeve për shlyerjen e taksave vendore për selinë qendrore dhe niptet sekondare nëse ka të tilla. Përfundimi i nxjerrë nga ju se meqenëse operatori ekonomi ka kontrata në qytete të tjera duhet të paraqese vërtetim edhe për këto vende ku ka ushtruar aktivitet është tërësisht i pabazuar pasi nuk mund të bëhet një korelacion i tillë midis tyre kryesive të cilat janë vendosur për qëllime tërësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe KPP në vendimin 514/2017 date 12.07.2017. Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj bashkisë ku ushtron aktivitet të regjistruara në QKB për periudhën e kërkuar për vitin 2016-2017. Pretendimi juaj nuk qëndron.

2. Lidhur me kriterin e mjeteve. Në lidhje me këtë pretendim operatori ka paraqitur deklaratën e disponimit të mjeteve sipas shtojcë 10 dhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST për secilin mjet. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga ky operator i cili na është vënë në dispozicion për shqyrtimin e kësaj ankese rezulton se të gjitha pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik BE-IS sh.p.k e përmbush këtë kriter kualifikimi. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

3. Nuk ploteson kushtin e percaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rremë e të pasakta, konsiderohen si kusht për skualifikim”, disa diploma janë paraqitur fotokopje të pashoqëruara me vërtetimin e Noterizimit/njehësimi kopjes origjinale me atë fotokopje. Ky pretendim i ngritur nga ana juaj nuk qëndron të gjitha dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik janë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Diplomat janë dokument bashkëngjitur i kontratave të punës dhe si i tillë nuk ka nevojë për vërtetim noterizimi.

4. Emri i administratorit të shoqërisë nuk gjendet në listpagesat pasi nuk figuron emri K.Ibrahimi në asnjë rresht të saj, por ekziston një emer tjetër K.Ibrahimaj cka do të thotë se nuk përputhet emri i administratorit në licencën e ndërtimit me asnjë punonjës aktual në listpagesat e shoqërisë. Emri i administratorit të kësaj shoqërie bazuar në ekstraktin tregtarë të paraqitur prej saj nuk është K.Ibrahimi sikundër ju pretendoni, por është K.Ibrahimaj i cili njekohësisht figuron si i tillë në listpagesat e shoqërisë dhe në Licencën e Ndërtimit të kësaj shoqërie. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

5. Referuar vërtetimit të numrit të punonjësve nga Administrata Tatimore të paraqitur nga operatori ekonomik BE-IS sh.p.k dhe Listë-pagesave të punonjësve të konfirmuar nga Administrata Tatimore shoqëruar me formularët e deklaramentit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore (FDP), formularët e deklaramentit të të ardhurave nga punësimi (TAP), numri mestar i punonjësve të këtij operatori ekonomik për periudhën e kërkuar e tejkalon ndjeshëm numrin 80. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

6. Sipas kriterit të mëposhtëm mbi deklarin e punëve në proces:[...] Deklarata e operatorit ekonomik BE-IS sh.p.k për të gjitha punët në proces për të cilat ka lidhur kontratë apo është në proces të lidhjes së saj, si kontraktor apo nënkontraktor, është përgjegjësi personale e deklaruesit. Komisioni vlereson se: Germa “ç”, pika 8, e nenit 26 “Kontratat per pune publike” është shfuqizuar me Vendimin Nr. 80 datë 14.02.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Ndërsa referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi Iib i cili përcakton; b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të perbashkët ose të vecantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4 Subjekti Be-IS sh.p.k për pikën NP-4 të Licences ka klasifikimin F e cila e lejon të kryej punime deri në 800 milion leke. Pretendimi juaj nuk qëndron.

7. Lidhur me kriterin e mëposhtëm për mjek. Në përmbushje të kriterit 2.3.5 Operatori ekonomik ka paraqitur kontraten noteriale e cila është e vlefshme dhe brenda afateve të kontraktuar. Gjithashtu e punësuar si mjek e përgjithshme figuron ne listpagesat e shoqërisë. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

8. Lidhur me kriterin e kapacitetit teknik: 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 7(shtatë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët:

- Teknik Ndërtimi me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI–sot) 3 (tre)
- Punonjës Elektriçist me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI–sot) 2 (dy)
- Punonjës Hidraulik me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI–sot) 2 (dy)
- 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë për punimet në lartësi të lëshuar nga Autoritetet Çertifikuese të Licensuara.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Tek inxhinierët e kërkuar ka mospërputhje mes librezës së punës, kontratës së punës dhe CV-së, gjithashtu rezultojnë kontrata të cilave u ka mbaruar afati. Ju keni renditur ndër pretendimet tuaja kriterin 2.3.6 të kapacitetit teknik dhe me poshtë ngrini pretendime në lidhje me kërkesat për inxhinjeret te cilat i perkasin kriterit 2.3.4 te kapacitetit teknik. Ne cdo rast i gjithë dokumentacioni i paraqitur ne permbushje te te dy kriterëve është ne perputhje te plote me kerkesat e DST-ve. Kontratat e punes jane te vlefshme dhe pozicioni i punes per te cilin punonjesit jane kontraktuar është ne perputhje me pozicionet e punes ne listpagese dhe me CV-në. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron. Ankesa është hartuar mbi bazën e aludimeve për dokumenta të cilat ju si operator ekonomik ankimes nuk ka si të keni dijeni duke qenë se janë të aksesueshme vetëm nga KVO. Nisur nga analiza e fakteve Komisioni i shqyrtimit të ankesës, vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik subjektit “Victoria Invest” sh.p.k.

II.6. Në datën 02.05.2018 operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke hequr dorë nga disa pretendime të ngritura pranë autoritetit kontraktor, por duke ngritur vetëm pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Duke qene se KPP eshte organi me i larte ne fushen e prokurimeve, brenda afatave ligjore pa iu drejtohem per arsyet e meposhtme:

1. Ne lidhje me pretendimin tone se operatori BE-IS SHPK nuk ploteson piken piken 2.1 te DST . Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë ku eshte eshte kerkuar: a) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017. Ju bejme me dije se: 1. Ne piken 2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë eshte kerkuar: a. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017. Operatori BE-IS Shpk me date 23.08.2017 ka lidhur kontrate per pune publike me Bashkine Bulqize me objekt “Qendra e qytetit te ri, sheshi para ish Keshillit te Rrethit, Bulqize” me vlere 24 213 546 lek me tvsh, lehtesisht e verifikueshme ne Buletinin e app, dhe portalin openprocurement.al. Per kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore per kete Bashki dhe nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Operatori BE-IS sh.p.k. ka lidhur kontrate per pune publike me date 29.09.2016 me Bashkine Cerrik me objekt “Ndertimi i Shkolles dhe Palestres. Ndertim i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen 9 vjecare Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik” me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore per kete Bashki dhe nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Ligji nr 9723 date 03.05.2007, i ndryshuar “Per Regjistrimin e Biznesit” konkretisht ne dispozitat ligjore te meposhtme: Referuar Nenit 2 pika 16: “Veprimtari eshte veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionle apo tregtare, e ushtruar ne menyre te vazhdueshme nga subjektet. Gjithashtu referuar ligjit 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, “Per procedurat Tatimore pika 1/1 ku citohet: “Ne perputhje me ligjin per regjistrimin e biznesit, aplikimi per ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia ne cdo rast behet perpara nisjes efektive te veprimtarise ne ate vend. Per hapjen e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me nje certifikate me numer unik identifikimi te njejte me ate te regjistrimit, por me numer serial te ndryshem. Kjo certifikate leshohet per te identifikuar vendodhjen e ushtrimit te veprimtarise, kur eshte e ndryshme nga selia. Subjekti BE-IS sh.p.k. ka ushtruar veprimtari te pavaruar ekonomike profesionale dhe tregtare për sa kohe ka lidhur me date 23.08.2017 kontrate për punë publike me Bashkine Bulqize me objekt “Qendra e qytetit te ri, sheshi para ish Keshillit te Rrethit, Bulqize” me vlere 24 213 546 lek me tvsh, lehtesisht e verifikueshme ne Buletinin e app, dhe portalin openprocurement.al. Per kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore per kete Bashki dhe nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Operatori BE-IS sh.p.k. ka lidhur kontrate per pune publike me date 29.09.2016 me Bashkine Cerrik me objekt “Ndertimi i Shkolles dhe Palestres. Ndertim i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen 9

vjecare Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik” me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Operatori BE-IS ne kete procedure ka paraqitur vertetime te taksave dhe tarifave vendore leshuar nga Bashkia Vore, Bashkia Kukes, Bashkia Tirane, Bashkia Vlore, per vitin 2016 dhe Bashkia Tirane, Bashkia Vlore, Bashkia Kruje, Bashkia Selenice, Bashkia Rrogozhine, Bashkia Durres, Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd, Bashkia Kukes, Bashkia Vlore per vitin 2017. Pra nuk ka paraqitur vertetim per Bashkine Cerrik dhe Bashkine Bulqizë. AK Bashkia Elbasan gabon ne arsyetimin e saj duke pretenduar se Operatori BE-IS ka shlyer te gjitha taksat dhe tarifave vendore per vitin 2016 dhe 2017 pasi AK Bashkia Elbasan i referohet vetem ekstraktit te QKB te paraqitur nga ky operator por AK Bashkia Elbasan bie ne kundërshtim me kriterin e vendosur nga vete AK pasi ne DST ka kerkuar ne piken 2.1 Per kapacitetin ligjor/profesional i operatoreve ekonomike ku eshte eshte kerkuar: a) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2016 dhe 2017. Pra ne asnje moment nuk eshte percaktuar qe operatorët duhet te paraqesin një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017 vetem sipas QKB. AK Bashkia Elbasan ne arsyetimin e saj i ben referim per analogji dhe vendimit te KPP 515/2017 date 12.07.2017, por ne kete vendim nuk ka asnje analogii me rastin e procedures, me objekt: “Rikonstruksioni i Rrugës "Caush Asllani" + Rruga "Ismail Xhemali Debrova” pasi... Sqarojme KPP se me kete vendim se operatori “Sireta 2F” sh.p.k, ishte s’kualifikuar nga procedura e prokurimit “Procedure e Hapur”, me Nr.REF-74760-03-29-2017 me objekt “Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi” me fond limit 78,906,342 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec per arsye se edhe pse kishte zhvilluar aktivitet ne vende te tjera dhe jo te deklaruar ne QKB nuk kishte paraqitur vertetim te taksave dhe tarifave vendore per keto vende te aktivitetit. KPP ne vendimin e saj 515/2017 date 12.07.2017 rrezon pretendimin e AK Bashkia Pogradec per Sireta 2F shpk pasi në DST ishte kerkuar: Nje dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, kjo jo vetem për selinë që jeni regjistruar por dhe per niptin sekondar nëse keni sipas ekstraktit historik te subjektit per vitin 2016 leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. Vërtetimi të jete lëshuar nga Autoriteti Vendor brenda 3 muajve nga data e hapjes se tenderit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimet si me siper lëshuar nga Qeverisjes Vendore në të cilën është regjistruar sipas QKB. Pra arsyetimi i AK Bashkia Elbasan nuk qendron, sa me larte kerkojme s’kualifikimin e operatorit BE-IS shpk pasi nuk permbush piken 2.1 te DST, per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë.

2. Ne lidhje me pretendimin tone se Operatori BE-IS shpk: nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte te Tenderit sipas të cilit: “Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim”. Ju bejme me dije se: Diplomat e paraqitura nga ana e Operatorit BE-IS shpk nuk jane origjinale ose fotokopje te noterizuara. AK Bashkia Elbasan gabon ne arsyetimin e saj ku pretendon se diplomat jane dokument i bashkengjitur i Kontratave te punes dhe si i tille nuk ka nevojë per vertetim noterizimi. Sqarojme KPP se sipas ligjit Nr.7829, date 01.06.1994 Per Noterine. neni 56 “ Vertetimi i njesise se kopjeve ose shkurttimeve me origjinalin”, “Noteri ben vertetimin e njesise se kopjeve e shkurttimeve te

dokumentave me origjinalin, pasi te kete krahasuar permbajtjen e tyre. Noteri duhet te permende ne vertetim se nga kush eshte paraqitur dokumenti, nga i cili eshte nxjerre kopja a shkurtimi, nese keto jane nxjene nga nje dokument origjinal apo nga ndonje kopje tjeter, si dhe shenime nese keto kane pasur korigjime, shtesa fshirje a shenja te tjera te vecanta. Fakti se Diplomat jane bashkelidhur kontrates se punes nuk i ben ato origjinale apo te njehsuara me origjinalin, pra operatori nuk permbush kerkesat lidhur me zoterimin e diplomave dhe ai duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjithe kriteret e vendosura nga AK. Sa me siper Operatori BE-IS shpk nuk ploteson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: “Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim”.

3. Operatori ekonomik nuk plotëson një punësim mesatar i të paktën 80 personave për periudhen Janar 2016 Dhjetor 2017 të vërtetuar me listepagesat e ketyre muajve. Ne periudhen e kerkuar "BE-IS" shpk ka nje numer mesatar prej 100 punonjesish por vetem me 2 kontratat ekzistuese si me poshte, i zene me shume se gjysmen e numrit mesatar te punetoreve ne kete periudhe. Rrjedhimisht nuk permbush numrin e punonjesve te kerkuar 80. Kontrate dt.28.03.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane “Rikonstruksion dhe shtesë anësore në ambjentet e kryesekretarisë së godinës civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”: 50 punetore-kohezgjatja e kontrates eshte 8 muaj. Kontrate dt 23.03.2018 Bashkia Tirane “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza I”: 13 punonjes-kohezgjatja e kontrates eshte 8 muaj. (bashkim oe me “Ergi” shpk & “Vëllezërit Hysa” shpk). Pergjigjia e Autoritetit Kontraktor eshte evazive duke thene se duke pare listepagesat e operatorit shihet se tejkalon ndjeshem numrin 80 punonjes. Punonjesit e kerkuar nga AK nevojiten per te kryer punimet dhe jo thjesht per njohuri ne shifra. Kjo duhet vertetuar me listepagesat e shoqerise por gjithashtu duhet marre parasysh se keto punonjes jane te angazhuar apo jo ne kontrata te tjera si me siper. Kjo do te sjell mosrealizim te kontrates se kerkuar nga AK.

4. Nuk jane deklaruar te gjitha kontratat per te cilat eshte shpallur fitues, gje qe vertetohet ne buletinin e njoftimeve te app. Thuhet nga AK se kjo deklarate eshte pergjegjesi personale e operatorit, por theksojme se AK duhet te beje verifikimet e tij lidhur me deklaratat e operatoreve. AK citon se operatori sipas licences se tij i lejohet te kryeje punime deri ne 800 milion leke, nderkohe qe kjo nuk do te thote qe operatori duhet te jape informacione te rreme ne deklaratat qe ai leshon. Sa me siper i kerkojme KPP shfuqizimin e vendimit te AK Bashia Elbasan vendim Nr. 777/11 Prot date 24.04.2018 dhe s'kualifikimin e BE-IS shpk nga procedura e prokurimit “Procedure e hapur”, me objekt: “Rikonstruksioni i Rruges Caush Asllani” + Rruga “Ismail Xhemali Debrova”.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2865/1 prot., datë 09.05.2018, protokolluar me tonën në datën 10.05.2018 me objekt “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Be-Is” sh.p.k. me arsyetimin se “[...]...operatori Be-Is shpk nuk ploteson piken 2.1 te DST . Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë ku eshte kerkuar: a) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2016 dhe 2017 [...]” Komisioni Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1.a “Për kapacitetin ligjor/profesional”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ”Be-Is” sh.p.k., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar në të cilin rezulton se shoqëria “Be-Is” sh.p.k. ka zyrë qendrore të shoqërisë në Kukës, Lagjja nr.1, pallati Metalurgu, hyrja nr.1. Ndërsa në sekionin 14 të ekstraktit të regjistrimit tregëtar “Vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit” listohen bashkitë Tiranë, Vorë, Selenicë.
- Vërtetim Nr.T00096903, datë 24.01.2018 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 24.01.2018
- Vërtetim Nr.1102 prot., datë 05.04.2016 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet vendore për vitin 2016.
- Vërtetim Nr.621 prot., datë 25.04.2016 lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2016.
- Vërtetim Nr.255 i prot., datë 03.03.2016 lëshuar nga Bashkia Vorë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka paguar detyrimet fiskale ndaj Bashkisë Vorë për vitin 2016.
- Vërtetim Nr.1019 prot., datë 10.03.2017 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet vendore për vitet fiskal 2015, 2016, 2017.
- Vërtetim Nr.1573 prot., datë 13.04.2017 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet vendore për vitet fiskal 2017.
- Vërtetim Nr.41904/1 prot., datë 11.04.2017 lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore deri në vitin 2017.

- Vërtetim datë 01.06.2017 lëshuar nga Bashkia Maliq me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet fiskale 2017.
- Vërtetim datë 22.06.2017 lëshuar nga Bashkia Krujë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. nuk ka detyrime pa likujduar për vitin 2017.
- Vërtetim Nr.205 prot., datë 28.06.2017 lëshuar nga Bashkia Vorë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2017.
- Vërtetim Nr.1870 prot., datë 11.08.2017 lëshuar nga Bashkia Selenicë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Selenicë për vitin 2017.
- Vërtetim Nr.1960 prot., datë 23.08.2017 lëshuar nga Bashkia Selenicë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Selenicë për vitin 2017, për objektin “Rehabilitim i kanaleve vaditëse të liqenit Harvala”.
- Vërtetim Nr.09/08 prot., datë 09.08.2017 lëshuar nga Bashkia Rrogozhinë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Rrogozhinë për periudhën 01.07.2017 deri 31.12.2017.
- Vërtetim Nr.extra prot., datë 24.08.2017 lëshuar nga Bashkia Durrës me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. nuk ka detyrime të palikujduara deri në datën e marrjes së vërtetimit.
- Vërtetim Nr.16 prot., datë 01.07.2016 lëshuar nga Bashkia Elbasan me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. nuk është i regjistruar në sistemin DTTV.
- Vërtetim Nr.114 prot., datë 30.05.2017 lëshuar nga Bashkia Elbasan me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Elbasan deri në momentin e lëshimit të këtij vërtetimi.
- Vërtetim Nr.396 prot., datë 08.11.2017 lëshuar nga Bashkia Elbasan me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. nuk ka detyrime në sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Elbasan.
- Vërtetim Nr.21 prot., datë 29.08.2017 lëshuar nga Bashkia Elbasan me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2017 pranë Bashkisë Elbasan. Subjekti nuk ka detyrime në sistemin e DTTV.
- Vërtetim Nr.6869/1 prot., datë 05.12.2016 lëshuar nga Bashkia Librazhd me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. nuk ka detyrime për taksa dhe tarifa vendore ndaj Bashkisë Librazhd.
- Vërtetim Nr.5655/1 prot., datë 22.09.2016 lëshuar nga Bashkia Librazhd me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2017 ndaj Bashkisë Librazhd dhe Njësive të saj Administrative.
- Vërtetim Nr.1371 prot., datë 19.02.2018 lëshuar nga Bashkia Vlorë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Vlorë për vitet 2016, 2017.
- Vërtetim Nr.1178 prot., datë 09.03.2018 lëshuar nga Bashkia Kukës me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka shlyer detyrimet vendore për vitin 2018.
- Vërtetim Nr.211901/1 prot., datë 08.03.2018 lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Be-Is” sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2018.

III.1.3. Operatori ekonomik ankimes pretendon: *”1. Ne lidhje me pretendimin tone se operatori BE-IS SHPK nuk ploteson piken piken 2.1 te DST. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve*

ekonomikë ku eshte eshte kerkuar: a) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017. Ju bejme me dije se: 1. Ne piken 2.1. Per kapacitetin ligior/profesional i operatorëve ekonomikë eshte kerkuar: a. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017. Operatori BE-IS Shpk me date 23.08.2017 ka lidhur kontrate per pune publike me Bashkine Bulqize me objekt “Qendra e qytetit te ri, sheshi para ish Keshillit te Rrethit, Bulqize” me vlere 24 213 546 lek me tvsh, lehtesisht e verifikueshme ne Buletinin e app, dhe portalin openprocurement.al. Per kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore per kete Bashki dhe nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Operatori BE-IS sh.p.k. ka lidhur kontrate per pune publike me date 29.09.2016 me Bashkine Cerrik me objekt “Ndertimi i Shkolles dhe Palestres. Ndertim i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen 9 vjecare Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik” me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore per kete Bashki dhe nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Ligji nr 9723 date 03.05.2007, i ndryshuar “Per Regjistrimin e Biznesit” konkretisht ne dispozitat ligjore te meposhtme: Referuar Nenit 2 pika 16: “Veprimtari eshte veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar ne menyre te vazhdueshme nga subjektet. Gjithashtu referuar ligjit 9920, date 19.05.2008 i ndryshuar, “Per procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet: “Ne perputhje me ligjin per regjistrimin e biznesit, aplikimi per ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia ne cdo rast behet perpara nisjes efektive te veprimtarise ne ate vend. Per hapjen e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me nje certifikate me numer unik identifikimi te njejte me ate te regjistrimit, por me numer serial te ndryshem. Kjo certifikate leshohet per te identifikuar vendodhjen e ushtrimit te veprimtarise, kur eshte e ndryshme nga selia. Subjekti BE-IS sh.p.k. ka ushtruar veprimtari te pavaruar ekonomike profesionale dhe tregtare për sa kohe ka lidhur me date 23.08.2017 kontrate për punë publike me Bashkine Bulqize me objekt “Qendra e qytetit te ri, sheshi para ish Keshillit te Rrethit, Bulqize” me vlere 24 213 546 lek me tvsh, lehtesisht e verifikueshme ne Buletinin e app, dhe portalin openprocurement.al. Per kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore per kete Bashki dhe nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Operatori BE-IS sh.p.k. ka lidhur kontrate per pune publike me date 29.09.2016 me Bashkine Cerrik me objekt “Ndertimi i Shkolles dhe Palestres. Ndertim i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen 9 vjecare Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik” me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Operatori BE-IS ne kete procedure ka paraqitur vertetime te taksave dhe tarifave vendore leshuar nga Bashkia Vore, Bashkia Kukes, Bashkia Tirane, Bashkia Vlore, per vitin 2016 dhe Bashkia Tirane, Bashkia Vlore, Bashkia Kruje, Bashkia Selenice, Bashkia Rrogozhine, Bashkia Durres, Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd, Bashkia Kukes, Bashkia Vlore per vitin 2017. Pra nuk ka paraqitur vertetim per Bashkine Cerrik dhe Bashkine Bulqizë. AK Bashkia Elbasan gabon ne arsyetimin e saj duke pretenduar se Operatori BE-IS ka shlyer te gjitha taksat

dhe tarifave vendore per vitin 2016 dhe 2017 pasi AK Bashkia Elbasan i referohet vetem ekstraktit te QKB te paraqitur nga ky operator por AK Bashkia Elbasan bie ne kundërshtim me kriterin e vendosur nga vete AK pasi ne DST ka kerkuar ne piken 2.1 Per kapacitetin ligjor/profesional i operatoreve ekonomike ku eshte eshte kerkuar: a) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2016 dhe 2017. Pra ne asnje moment nuk eshte percaktuar qe operatorët duhet te paraqesin një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017 vetem sipas QKB. AK Bashkia Elbasan ne arsyetimin e saj i ben referim per analogji dhe vendimit te KPP 515/2017 date 12.07.2017, por ne kete vendim nuk ka asnje analogji me rastin e procedures, me objekt: “Rikonstruksioni i Rruges "Caush Asllani" + Rruga "Ismail Xhemali Debrova” pasi... Sqarojme KPP se me kete vendim se operatori “Sireta 2F” sh.p.k, ishte s’kualifikuar nga procedura e prokurimit “Procedure e Hapur”, me Nr.REF-74760-03-29-2017 me objekt “Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi” me fond limit 78,906,342 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec per arsye se edhe pse kishte zhvilluar aktivitet ne vende te tjera dhe jo te deklaruar ne QKB nuk kishte paraqitur vertetim te taksave dhe tarifave vendore per keto vende te aktivitetit. KPP ne vendimin e saj 515/2017 date 12.07.2017 rrezon pretendimin e AK Bashkia Pogradec per Sireta 2F shpk pasi në DST ishte kerkuar: Nje dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, kjo jo vetem për selinë që jeni regjistruar por dhe per niptin sekondar nëse keni sipas ekstraktit historik te subjektit per vitin 2016 leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. Vërtetimi të jete lëshuar nga Autoriteti Vendor brenda 3 muajve nga data e hapjes se tenderit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimet si me siper lëshuar nga Qeverisjes Vendore në të cilën është regjistruar sipas QKB. Pra arsyetimi i AK Bashkia Elbasan nuk qendron, sa me larte kerkojme s’kualifikimin e operatorit BE-IS shpk pasi nuk permbush piken 2.1 te DST, per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë.”

III.1.4. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes argumenton se: “Ne lidhje me pretendimin tuaj se subjekti BE-IS sh.p.k ka lidhur kontrate per pune publike me date 29.09.2016 me Bashkine Cerrik me objekt “Ndertimi i Shkolles dhe Palestres. Ndertimi i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik” me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk e ka deklaruar ne QKB si adrese dytesore te ushtrimit te aktivitetit dhe si rrjedhoje nuk ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave vendore sqarojme se autoriteti kontraktor ne vlerësimin nese operatori ekonomik ka shlyer detyrimet qe rrjedhin nga taksat vendore duhet ti referohet vetem vendeve kryesore dhe sekondare te ushtrimit te aktivitetit tregetar referuar ekstraktit te regjistrit tregetar. Eshte jashte kompetencave te autoritetit kontraktor ne cilesine e nje organi publik bashki te verifikojte zbatueshmerine e ligjit nga organet e qeverisjes vendore ne rast se keto te fundit kane nisur proceduren e dergimit te kerkeses per regjistrim dhe detyrimin e pagimit te taksave vendore. Ndaj nenvizojme se referuar pretendimit tuaj të mësipërm per skualifikim kjo arsye eshte ne tejkalim të kompetencave dhe i eshte referuar nje kriteri i cili nuk eshte parashikuar ne dokumentat e tenderit duke rene ndesh me

nenin 55 pika 2 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar . III.2.5 Ne nenin 46, pika 1, germa "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet [...]. 111.2.6. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet [...] 111.2.7. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kërkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. III.2.8. Referuar sa më sipër KSHA vlerëson se në kriterin e vecantë të kualifikimit a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar aktivitetet per vitet 2016 dhe 2017 nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga operatori ekonomik "BE-IS" shpk në përmbushje të këtij kriteri ky i fundit ka dorëzuar vërtetime lëshuar nga Bashkia Vorë, Bashkia Kukës, Bashkia Tiranë, Bashkia Vlorë për vitin 2016 dhe Bashkia Tiranë, Bashkia Vorë, Bashkia Krujë, Bashkia Selenicë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Durrës, Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd, Bashkia Kukës, Bashkia Vlorë për vitin 2017 me anë të të cilave konfirmohet se ofertuesi nuk ka detyrime të papaguara lidhur me takstat dhe tarifave vendore për Vitet 2016-2017 për këto Bashki. Nga verifikimi i ekstraktit të regjistrit tregëtar të ofertuesit të paraqitur në SPE rezulton se ky i fundit ka ushtruar aktivitetin e tij ekonomik vetëm në Bashkinë Vorë, Bashkinë Kukës, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vlorë për vitin 2016 dhe Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vorë, Bashkinë Krujë, Bashkinë Selenicë, Bashkinë Rrogozhinë, Bashkinë Durrës, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Librazhd, Bashkinë Kukës, Bashkinë Vlorë për vitin 2017, për të cilat ka paraqitur vërtetimet përkatëse. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se pretendimi juaj per operatorin ekonomik "BE-IS" shpk se ka lidhur kontrate per pune [ublike me date 29.09.2016 me Bashkinë Cerrik me objekt "Ndertimi i Shkolles dhe Palestres, Ndertimi i Terreneve Sportive dhe Sistemim i Territorit ne Shkollen Adem Elmaz Asllani, Shtepanje, Gostime, Bashkia Cerrik" me vlere 72 948 120 me tvsh me afat 90 dite. Kete kontrate ky operator edhe pse ka ushtruar aktivitet nuk e ka deklaruar ne QKB si adrese dytesore te ushtrimit te aktivitetit dhe si rrjedhoje nuk ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe nuk ka paraqitur dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave vendore, jane te pa pabazuara dhe jo në përputhje me kriteret e kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka detyrimin te vlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentat e procedures se prokurimit. Në rastin konkret Komisioni gjykon se ju keni keqinterpretuar kriteret e vendosura nga AK si dhe ligjin për taksat vendore duke kerkuar me pa të drejtë skualifikimin e operatorin ekonomik. Vlerësimi nëse operatorët ekonomikë kanë shlyer detyrimet vendore bëhet në bazë të verifikimit të vendeve të ushtrimit të aktivitetit në periudhën e kërkuar pasi ky është dhe qëllimi dhe fryma e ligjit që detyron subjektet të regjistrojnë vendet ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Në rastin konkret operatori ekonomik "BE-IS" shpk për vitin 2016 -2017 rezulton të ketë shlyer të gjitha detyrimet vendore per vendet e ushtrimit të aktivitetit të regjistruara në QKB duke përmbushur tërësisht kërkesat e kriterit të kualifikimit per dorëzimin e vërtetimeve për shlyerjen e taksave vendore per selinë qendrore dhe niptet sekondare nëse ka të

tilla. Përfundimi i nxjerë nga ju se meqenëse operatori ekonomi ka kontrata në qytete të tjera duhet të paraqese vertetim edhe per këto vende ku ka ushtruar aktivitet është tërësisht i pabazuar pasi nuk mund të bëhet një korelacion i tillë midis ty kriterëve të cilat janë vendosur për qëllime tërësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe KPP në vendimin 514/2017 date 12.07.2017. Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj bashkisë ku ushtron aktivitet të regjistruara në QKB per periudhën e kërkuar për vitin 2016-2017. Pretendimi juaj nuk qëndron.”

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Referuar sa më sipër Komisioni konstaton se, në kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ”Be-Is” sh.p.k., konkretisht, nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të Regjistrimit të kësaj shoqërie, rezulton se, kjo e fundit ushtron aktivitet në Republikën e Shqipërisë me Zyrë Qëndrore në Kukës, Kukës, Lagja nr.1, Pallati Metalurgu, hyrja nr.1, si edhe referuar këtij Ekstraktit në pikën 14 Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit ushtron aktivitet në Tiranë, Vorë, Selenicë. Gjithashtu në këtë ekstrakt në pjesën Historiku i Regjistrimit, rezulton që për vitin 2016 shoqëria “Be-Is” sh.p.k. ka ushtruar aktivitet në bashkitë Vorë dhe Kukës, ndërsa për vitin 2017 kjo shoqëri ka ushtruar aktivitet në bashkitë Tiranë, Maliq, Krujë, Vorë, Selenicë, Rrogozhinë, Durrës, Elbasan, Librazhd. Operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka dorëzuar vërtetime të lëshuara nga Bashkitë në të cilat ka kryer aktivitet për vitet 2016, 2017 sipas ekstraktit të QKB. Sa më sipër, nga shqyrtimi i ekstraktit historik të shoqërisë, të lëshuar nga QKB dhe vërtetimeve të lëshuara nga institucionet vendore të bashkive ku operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. ka ushtruar aktivitet, konfirmohet se ofertuesi nuk ka detyrime të papaguara lidhur me taksat dhe tarifatat vendore për vitet 2016 dhe 2017 për vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij tregtar.

Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimes se operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. gjatë viteve 2016-2017 ka ushtruar aktivitet në Bashkitë Bulqizë dhe Cërrik, por nuk ka paraqitur

dokumentat me anë të të cilit të vërtetojë se ka paguar taksat dhe tarifën vendore për këto bashki, KPP arsyeton se referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar të shoqërisë “Be-Is” sh.p.k., nuk rezulton që kjo shoqëri të ketë kryer anktivitet në këto dy bashki gjatë viteve 2016, 2017. Duke qenë se sipas legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregëtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, të kryejë regjistrimet në regjistrin tregëtar, të kryejë regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës, të lëshojë certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, të publikojë të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to, atëherë edhe verifikimi i vendeve ku shoqëria “Be-Is” sh.p.k. ka kryer aktivitetin e saj gjatë viteve 2016, 2017 do të bëhet referuar ekstraktit të publikuar nga QKB për këtë shoqëri.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj vendeve ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016, 2017.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Be-Is” sh.p.k. me arsyetimin se “[...]...Diplomat e paraqitura nga ana e operatorit BE-IS shpk nuk jane origjinale ose fotokopje te noterizuara. [...]” Komisioni Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, paragrafi i fundit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

III.2.2. Gjithashtu në në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, stafin inxhinierik si më poshtë:

- Ing. Ndërtimi 2(dy) ku njeri te jete i profilit transport infrastrukure
- Ing. Hidroteknik 1 (nje)
- Ing. Elektrik 1 (një)
- Ing. Gjeodet 1 (një)
- Nje person te pajisur me certifikate te Mbrojtjes se Shendetit dhe Sigurimin ne pune.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Be-Is” sh.p.k., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Diploma për punonjësit e kërkuar.

III.2.4. Operatori ekonomik ankimes pretendon: *“Ju bejme me dije se: Diplomat e paraqitura nga ana e Operatorit BE-IS shpk nuk jane origjinale ose fotokopje te noterizuara. AK Bashkia Elbasan gabon ne arsyetimin e saj ku pretendon se diplomat jane dokument i bashkengjitur i Kontratave te punes dhe si i tille nuk ka nevojë per vertetim noterizimi. Sqarojme KPP se sipas ligjit Nr.7829, date 01.06.1994 Per Noterine. neni 56 “Vertetimi i njesise se kopjeve ose shkurtimeve me origjinalin”, “Noteri ben vertetimin e njesise se kopjeve e shkurtimeve te dokumentave me origjinalin, pasi te kete krahasuar permbajtjen e tyre. Noteri duhet te permende ne vertetim se nga kush eshte paraqitur dokumenti, nga i cili eshte nxjerre kopja a shkurtimi, nese keto jane nxjene nga nje dokument origjinal apo nga ndonje kopje tjeter, si dhe shenime nese keto kane pasur korigjime, shtesa fshirje a shenja te tjera te vecanta. Fakti se Diplomat jane bashkelidhur kontrates se punes nuk i ben ato origjinale apo te njehsuara me origjinalin, pra operatori nuk permbush kerkesat lidhur me zoterimin e diplomave dhe ai duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjithë kriteret e vendosura nga AK. Sa me siper Operatori BE-IS shpk nuk ploteson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: “Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim”.*

III.2.5. Autoriteti kontrator në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes argumenton se: *“Ky pretendim i ngritur nga ana juaj nuk qëndron të gjitha dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik janë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Diplomat janë dokument i bashkëngjitur i Kontratave të punës dhe si i tillë nuk ka nevojë për vërtetim noterizimi.”*

III.2.6. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.* Ndërsa në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.7. Në Manualin nr.1, datë 26.01.2018 “Për rregjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në faqen 17 e tij, paragrafi i parë thuhet se: *“Dokumentat e skanuar duhet të jenë origjinal ose kopje e noterizuar, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet ne sistemin e prokurimit elektronik, për një procedurë konkrete është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar”.*

III.2.8. Për sa i përket pretendimeve të autoritetit kontraktor, lidhur me diplomat e dorëzuara për punonjësit e kërkuar, Komisioni gjykon se procesi i dorëzimit të dokumentave prej operatorëve ekonomikë në S.P.E. lidhet me konvertimin e tyre nga hard copy në informacion dixhital (elektronik), informacion ky tashmë i aksesueshëm vetëm nëpërmjet kompjuterit dhe për të cilin nuk ka më kuptim gjykimi i origjinalitetit dhe askush nuk mund të gjykojë nëse një dokument në format elektronik është kopje apo original. Për më tepër që operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit ku marrin pjesë, dorëzojnë deklarata mbi përgjegjësinë që ata mbajnë për dokumentacionin që paraqesin.

III.2.9. Në Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 09.05.2017 “Për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ofertave në Prokurimin me Mjete Elektronike”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorit ekonomik të shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës, i kërkohet të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili, verifikohet nga KVO-ja dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.” Përsa cituar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se versioni i skanuar i dokumentave pasi hidhet në sistemin elektronik të prokurimit për një procedurë konkrete, është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar, në rastin konkret.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Be-Is” sh.p.k. me argumentin se “Operatori ekonomik nuk plotëson një punësim mesatar i të paktën 80 personave për periudhën Janar 2016 Dhjetor 2017 të vërtetuar me listepagesat e ketyre muajve. Ne periudhën e kerkuar “BE-IS” shpk ka nje numer mesatar prej 100 punonjesis por vetem me 2 kontratat ekzistuese si me poshte, zene me shume se gjysmen e numrit mesatar te punetoreve ne kete periudhe. Rrjedhimisht nuk permbush numrin e punonjesve te kerkuar 80”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën 80 (tetëdhjetë) personave të siguruar për periudhën Janar 2016 -Dhjetor 2017. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listë-pagesat e punonjësve të konfirmuar nga Administrata Tatimore shoqëruar me formularët e deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore (FDP), formularët e deklarimit të të ardhurave nga punësimi (TAP).

III.3.2. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipër të vendosur nga autoriteti kontraktor, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimimi për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2017.
- Vërtetim Nr. 2287 prot, datë 23.10.2017 “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin – E-Sig 02/a), për vitin 2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës.
- Vërtetim Nr. T00096825, datë 24.01.2018 “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin – E-Sig 02/a), për vitin 2016-2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës.
- Vërtetim Nr. T00164562, datë 08.03.2018 “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin – E-Sig 02/a), për vitin 2015-2016-2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat

e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.3.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.5. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmëri në e tyre.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka parashikuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë se për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2017 disponojnë minimumi 80 punonjës të siguruar, dokumentuar kjo me vërtetimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore lëshuar nga Administrata Tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi. Sa më sipër, KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k., konstaton se ky i fundit në përmbushje të kërkesës së vendosur nga autoriteti kontraktor për të paktën 80 punonjës të siguruar, ka dorëzuar vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi, me anë të të cilave vërtetohet se operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2017, disponon një numër mesatar punonjësish të siguruar sipas kërkesës së vendosur nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit.

III.3.7. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. se “Në periudhën e kërkuar “Be-Is” shpk ka nje numer mesatar prej 100 punonjesish por vetem me 2 kontratat ekzistuese si me poshte, i zene me shume se gjysmen e numrit mesatar te puntoreve ne kete periudhe. Rrjedhimisht nuk permbush numrin e punonjesve te kerkuar 80. Kontrate dt.28.03.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë “Rikonstruksion dhe shtesë anësore në ambjentet e kryesekretarisë së godinës civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë”: 50 punetore-

kohezgjatja e kontrates eshte 8 muaj. Kontrate dt 23.03.2018 Bashkia Tirane “Ndërtimi i rrugëve Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza I”: 13 punonjes-kohezgjatja e kontrates eshte 8 muaj. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2017 duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 80 (tetëdhjetë) persona të siguruar. Në këtë rast, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka detyrimin të vlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentat e procedurës së prokurimit dhe jo të gjykojë mbi kritere të pavendosura. Pra, operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriterin e vendosur nga ana e autoritetit kontraktor.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Be-Is” sh.p.k. me argumentin se “Nuk jane deklaruar te gjitha kontratat per te cilat eshte shpallur fitues, gje qe vertetohet ne buletin e njoftimeve te app.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

Operatori ekonomik _____ nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.

Operatori ekonomik _____ që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

III.4.2. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.10, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të plotesoje kërkesat e Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi Iib si dhe të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 914, date 29.12.2014, neni 26, pika 8, germa “ç”. Për të provuar plotesimin e kesaj kerkese duhet të deklaroje të gjitha punet ne proces per të cilat ka lidhur kontrate apo eshte ne proces te lidhjes se saj, si kontraktor apo nenkontraktor, sipas ligjit për prokurimin publik, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Objekti I kontrates	Autoriteti Kontraktore	Vlera e kontrates pa tvsh	Dat e fillimit te punimeve ose data e parashkuar per lidhjen e kontrates	Dat e perfundimit te punimeve ose data e parashkuar per perfundimin e kontrates	Masa e perfundimit te punimeve fizike ne %
<u>1</u>						
<u>2</u>						
<u>3</u>						

<u>4</u>						
----------	--	--	--	--	--	--

III.4.3. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces (sipas shtojcës 11).
- Deklaratë për punët në proces (sipas Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.10).

III.4.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Aftësia teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.4.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.4.5. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmërinë e tyre.

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të deklarojnë të gjitha punët në process, nëpërmjet dorëzimit të shtojcës përkatëse të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, ky i fundit, në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për punët në proces, ka paraqitur deklaratat përkatëse sipas këtyre përcaktimeve të bëra përkatësisht në shtojat 11 dhe 12. Konkretisht, operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. ka paraqitur shtojcat 11 dhe 12, në të cilat

evidentohet se janë plotësuar të gjitha të dhënat sipas kërkesave që përmbajnë këto shtojca. Sqarojmë se është detyrë dhe përgjegjësi e operatorëve ekonomikë të paraqesin të gjithë dokumentacionin e duhur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, si edhe në përputhje me dokumentat e tenderit.

Referuar ndryshimeve ligjore, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 26 *Kontratat për punë publike*, pika 8, gërma “d”, është vendosur si më poshtë vijon: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: d) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”*, duke përcaktuar se, ky kriter do të vërtetohet nëpërmjet vetëdeklarimit të bërë nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Ashtu siç edhe autoriteti kontraktor informon, sqarojmë se plotësimi i kësaj deklarate është përgjegjësi e operatorit ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike, që në këtë rast është paraqitur nga operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. III.4.7. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se: *“Nuk janë deklaruar të gjitha kontratat për të cilat është shpallur fitues, gjë që vërtetohet në buletinin e njoftimeve të APP. Thuhet nga AK se kjo deklaratë është përgjegjësi personale e operatorit, por theksojmë se AK duhet të bëjë verifikimet e tij lidhur me deklaratat e operatorëve. AK citon se operatori sipas licencës së tij i lejohet të kryejë punime deri në 800 milion lekë, ndërkohë që kjo nuk do të thotë që operatori duhet të japë informacione të rreme në deklaratat që ai lëshon [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e vetë operatorit ekonomik ankimues nuk jepen fakte e prova mbi pretendimet që ngre, por thjesht citon se *“nuk janë deklaruar të gjitha kontratat për të cilat është shpallur fitues[...] ndërkohë që kjo nuk do të thotë që operatori duhet të japë informacione të rreme”*, duke mos paraqitur faktet mbi të cilat e mbështet këtë pretendim, ndërkohë që nga ana e operatorit ekonomik “Be – Is” sh.p.k. janë paraqitur deklaratat përkatëse sipas kriterit si më sipër cituar, të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se në lidhje me dyshimet e ngritura nga ana e operatorit ekonomik ankimues, përsa i përket deklaratës së paraqitur nga operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k. në lidhje me punët në proces, ankimuesi mund t’i drejtohet organeve përkatëse për të verifikuar deklaratimet e bëra nga operatori ekonomik “Be-Is” sh.p.k.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me nr. REF- 44820-02-07-2018, me objekt *“Rikonstrukcion i rrugës “Çaush Asllani” + rruga “Ismail Xhemali Debrova”*, me fond

limit 47.303.370 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 845 Protokolli

Datë 02.05.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

